REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR. 658 Rep.
NR. 187 Kol.

NOTER TIRANË

KONTRATË SHTESË KONCESIONI
PËR
NJË NDRYSHIM NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS "BOT" (NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM) NR.1605 Rep., Nr.1037/4 Kol., datë 18.07.2018 PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT "VELESHICË", E NDRYSHUAR"

Në Tiranë, më datë 02, muaji Mars, viti 2022 (dymijë e njëzetë e dy), para meje noter _____, anëtar i dhomës së Noterisë TIRANË, me adresë _____, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar me autorizim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 1966, datë 28.02.2022 (kopje bashkëlidhur) nga Z. _____, i datëlindjes _____, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Letërnjoftim ID _____

DHE

Shoqërisë koncesionare **"KALISI HYDROPOWER"** sh.p.k, themeluar si person juridik datë 14.06.2018 dhe regjistruar në QKB datë 18.06.2018, me NUIS L81818009A, e përfaqësuar ligjërisht nga administratori i shoqërisë Z. _____, i datëlindjes _____ madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar për identitetin e të cilit u sigurova nga Letërnjoftim me ID me nr. Personal _____

të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë Koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së Koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim) për ndërtimin e hidrocentralit "Veleshicë", me Nr. 1605 Rep., Nr. 1037/4 Kol., lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoritet Kontraktues) dhe Subjektit për Qëllime të Veçanta shoqërisë "Kalisi Hydropower" sh.p.k, (Koncesionari), hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datë 18 Korrik 2018, e ndryshuar, me Kontratën shtesë Nr. 7 Rep., Nr.3/1 Kol., datë 03.01.2019 "Kontratë Shtesë Koncesioni për disa ndryshime në kontratëne koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim, Operim, Transferim) të lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë "Kalisi Hydropower" sh.p.k, për ndërtimin e hidrocentralit "Veleshicë".

Hyrje

Duke pasur parasysh që:

Ministrisë [illegible] Infrastrukturës dhe Energjisë (A[illegible] [illegible] Infrastructures dhe E[illegible] [illegible] Kalisi i [illegible] Kontrata e Koncesionit e formës "BOT" me [illegible] Kontratën e Koncesionit [illegible] 2018, ndryshuar për ndërtimin e hidrocentraleve "Veleshicë", (më vijim referuar si "Hidro[illegible] Kontrata e Koncesionit), e ndryshuar me:

- Kontratën Shtesë Nr. 7 Rep., Nr.3/1 Kol., datë 02.01.2019 "Kontratë Shtesë Koncesioni" për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim, Operim, Transferim) të lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë "Kalisi Hydropoëer" sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit "Veleshicë".

Shoqëria koncesionare *"Kalisi Hydropoëer"* sh.p.k me shkresë Nr. 1186 Prot., datë 04.02.2022 *"Kërkesë për kontratë shtesë koncesioni për objektin ndërti i burimit të ri gjenerues të energjisë të Hec Veleshica 1 dhe Veleshica 2"*, protokolluar në MIE me Nr. 1186 Prot., datë 04.02.2022, ka kërkuar kontratë shtesë të programit të punimeve me një afat prej 18 muajsh për vënien në punë të Hec "Veleshicë" për shkak të vonesave që kanë ardhur sipas shkaqeve që shoqëria ka parashtruar në kërkesën e saj.

- Gjatë zbatimit të punimeve të HEC-it një pjesë e makinerive dhe fuqisë punëtore për një periudhë 5 mujore kanë punuar për nevojat e komunitetit të zonës për sistemimin e rrugëve ekzistuese, rrugëve të reja si dhe pastrimit të kanalit vaditës të fshatrave, ku do të zbatohej projekti sipas marrëveshjeve të bëra midis shoqërisë dhe banorëve të zonës, gjë që ka sjellë vonesa në zbatimin e punimeve të hidrocentralit.

- Për shkak të situatës së pandemisë Covid 19 dhe masat e marra nga Qeveria Shqiptare për kufizimin e shërbimeve, shoqëria nga fillimi se punimet për ndërtimin e Hec Veleshica u ndërprenë dhe kjo solli vonesa për realizimin e punimeve në afatin e parashikuar në kontratën e koncesionit .

- Bashkia Kukës me Urdhërin Nr.576 datë 12.06.2020 "Mbi bllokimin e aktivitetit të shoqërisë Kalisi Hydropower" dhe procesverbalin e policisë bashkiake Kukës i cili mban datën 18.06.2020 ka bllokuar aktivitetin e shoqërisë "Kalisi Hydropower" sh.p.k. Gjatë punimeve të hapjes së sheshit të godinës Hec Veleshica 1 si pasojë e problemeve gjeologjike të ndikuara nga kushtet atmosferike ka ndodhur rrëshqitje dheu dhe punimet u përqendruan në pastrimin e dherave dhe sistemin e sheshit të godinës dhe jo në realizimin e punimeve për hidrocentralin Veleshica 1.

- Pas përfundimit të Hec Veleshica 2 gjatë fazës së testimit ka ndodhur avari e cila u pasua me dëmtime të pajisjeve elektro-mekanike të hidrocentralit duke sjellë vonesa në realizimin e punimeve, si dhe duke qenë se bashkia Kukës dhe bashkia Dibër karakterizohen me dimër të gjatë dhe rreshje të mëdha të borës punimet kanë ecur me ritme të ngadalta.

- Gjithashtu gjatë periudhës së muajve Maj-Shtator nuk realizohen punime zbatimi për ndërtimin e nënobjekteve në kanalin e derivacionit dhe të veprës së marrjes, pasi këto nënobjekte ndjekin trasenë e kanalit të vaditjes i cili përdoret për ujitje dhe vaditje nga banorët e zonës në këtë periudhë të vitit duke respektuar edhe marrëveshjen midis shoqërisë dhe banorëve për vaditje.

Fq. 1

- Shoqëria koncesionare "Kalisi Hydropower" sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin [illegible] ergjisë (Autoriteti Kontraktues) [illegible] pretendimet për vonesa të shkaktuara për ndërtimin e [illegible] ropower" sh.p.k. [illegible] Ministrisë [illegible] Nr. 1605 Rep., Nr. 1037/4 Kol., datë 18 Korrik [illegible] ntraleve "[illegible]
- Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 26.03.2020 "*Për shpalljen e [illegible] gjendje e së fatkeqësisë natyrore*", i ndryshuar, Aktit Normativ Nr. 3, datë 15.03.2020 "*Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19*", i ndryshuar,

- Neni 4 "Periudha e koncesionit" pika 4.2 ii parashikon se "Palët bien dakord se Periudha e koncesionit do të zgjatet në rastin e një "Ngjarje të Forcës Madhore: për një periudhë të barabartë me kohën që ka zgjatur ngjarja dhe kohën e arsyeshme për riparimin e dëmeve të shkaktuara, me kusht që vet ngjarja të ketë zgjatur një periudhë kohe që kalon 1 (një) muaj"

- Referuar nenit 20 "Forca Madhore" pika 20.1 ku parashikohet se: "Konsiderohen Ngjarje të Forcës Madhore" i Katastrofat Natyrore, përmbytjet, tërmetet, ndotjet nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me to"

- Palët njohin dhe pranojnë kufizimet dhe vonesat e shkaktuara për shkak të panedemisë së krijuar nga COVID-19" si dhe;

- Mbështetur në nenin 28 "Ndryshime" të Kontratës së Koncesionit, ku parashikohet se:

- 28.1 Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim , shtesa dhe /ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve;
- 28.2 Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo aneksëve bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do. të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.
- Në nenin 29 "Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit" të Kontratës së Koncesionit, ku parashikohet se Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit;

- Në Kontratën e Koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim) me Nr. 1605 Rep., Nr. 1037/4 Kol., lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti Kontraktues) dhe shoqërisë "Kalisi Hydropower" sh.p.k, (Koncesionari), për ndërtimin e hidrocentraleve "Veleshicë", hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datë 18 Korrik 2018, e ndryshuar të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Neni 1

Në nenin 10 "Programi i Punimeve" pika 2 zëvendësohet me shprehjen "Koncesionari merr përsipër të vendosi në punë hidrocentralin brenda një afati prej 18 muajsh nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate shtesë koncesioni.

Fq

A20220538400198 1605

Kjo Kontratë Shtesë koncesioni hyn në fuqi pas nënshkrimit nga palët.

Kontrata Shtesë e Koncesionit u hartua në 5 (pesë) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES	SHOQËRIA KONCESIONARE
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	**"Kalisi Hydropower" sh.p.k**
Përfaqësuar me Autorizim Nr. 1965, datë 28.02.2022 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nga	**Përfaqësuar nga**
Z.	Z.
	ADMINISTRATOR